



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

KOMUNA SHËNKOLL

PLANI I ZHVILLIMIT TË KOMUNËS SHËNKOLL



**PLANI I ZHVILLIMIT
TË KOMUNËS
SHËNKOLL**

TABELA E PËRMBAJTJES

Pse Duhet të Hartojmë një Plan për Zhvillimin Lokal?	7
Parimet Udhëzuese të Planeve të Zhvillimit Lokal në Komunitet e Shqipërisë	8
Plani i Zhvillimit Lokal të Komunës është	8
Komponentët e Planit të Zhvillimit Lokal të FSHZH	8
Kush u përfshi në hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal?	10
Si realizohet procesi?	11
Cili është afati kohor për Planin e Zhvillimit Lokal?	13
Profili i Komunës Shënkoll	15
Profili i Komunës Shënkoll	17
Informacion i Përgjithshëm për Komunën e Shënkoll	17
1. SHOQËRIA (KAPITALI SOCIAL)	18
a. Komuniteti dhe Dinamika e tyre	18
b. Arsimimi	19
c. Kultura dhe Koha e Lirë	20
d. Shërbimi Shëndetësor	20
e. Asistenca Sociale	21
f. Cilësia e Jetës	22
2. EKONOMIA	23
a. Situata e Përgjithshme	23
b. Bujqësia	23
c. Blegtoaria	26
d. Agropërpunimi	28
e. Shfrytëzimi burimeve natyrore e ndërtimi	28
f. Tregtia	29
g. Shërbimet dhe transporti	29
3. MJEDISI DHE INFRASTRUKTURA	30
a. Pozita Gjeografike e Komunës	30
b. Burimet Natyrore	30
c. Toka	30
d. Klima	31
e. Shfrytëzimi burimeve natyrore	31
f. Shfrytëzimi inerteve në lumin Mat	32

c. Sistemi Rrugor	33
d. Furnizimi me Energji Elektrike.....	34
e. Furnizimi me Ujë të Pijshëm	34
f. Kanalizimi i Ujrave të Zeza dhe të Bardha	35
4. QEVERISJA LOKALE.....	36
a. Burimet financiare të Komunës.....	37
b. Shërbimet e kryera nga Komuna	40
c. Pjesëmarrja Qytetare.....	40
DEKLARATA E VIZIONIT	40
Fusha Prioritare: Zhvillimi Ekonomik	42
Hapat e Veprimit	42
Qëllimi strategjik 1: Zhvillimi i Bujqësisë	44
Qëllimi Strategjik 2: Zhvillimi i Blegtorisë.....	45
Qëllimi Strategjik 3: Zhvillimi i Agrobiznesit	46
Qëllimi Strategjik 1: Zhvillimi i Turizmit dhe Agroturizmit	47
Fusha Prioritare: Infrastruktura dhe Shërbimet Publike	48
Hapat e veprimit	48
Qëllimi Strategjik 1: Përmirësimi i sistemit rrugor	50
Qëllimi Strategjik 2: Hartimi i masterplanit për gjithë teritorin e Komunës	51
Qëllimi Strategjik 3: Sigurimi i ujit të pijshëm dhe shtrirja e rrjetit të KUZ	52
Qëllimi strategjik 4: Sistemimi i qendrave të fshatrave të komunës	53
Fusha Prioritare: Zhvillimi Social	54
Hapat e Veprimit	54
Qëllimi strategjik 1: Përmirësimi i jetës social -kulturore në komunë	56
Qëllimi strategjik 2: Përmirësimi i sistemit arsimor dhe shëndetësor	57
Qëllimi strategjik 3: Përmirësimi i shërbimeve publike	58
Fusha Prioritare: Qeverisja e Mirë	59
Hapat e Veprimit	59
Qëllimi Strategjik 1: Përmirësimi i informimit	61
Qëllimi Strategjik 2: Rritja e transparencës	62
Qëllimi Strategjik 3: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar	63
Qëllimi Strategjik 4: Stimulimi i angazhimit të banorëve në vendim-marrje	64
Qëllimi Strategjik 5: Përmirësimi i të ardhurave lokale	65
Local Development Plan	66

Plani i Zhvillimit Lokal i komunës Shënkoll është përgatitur nga grupi i Planit të Zhvillimit Lokal të krijuar në komunë, me asistencën teknike të ofruar nga Njësia e Planeve të Zhvillimit Lokal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Metodologjia

Tashmë, u bënë vite që FSHZH është identifikuar si një nga aktorët kyç në hartimin e planeve strategjike të njësive të qeverisjes vendore. Kjo përpjekje është në vazhden e angazhimit të FSHZH për të ngritur kapacitetet e njësive të qeverisjes vendore dhe komuniteteve lokale.

Pse Duhet të Hartojmë një Plan për Zhvillimin Lokal?

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces që i jep mundësi qeverisjes lokale— dhe banorëve që ajo përfaqëson — të kontrollojnë dhe të hartojnë të ardhmen e tyre. Një Plan Zhvillimi Lokal jep informacion mbi drejtimin e veprimeve drejt zhvillimit të një komuniteti. PZHL është një hartë për t'u ndjekur nga të zgjedhurit, personeli i komunës, dhe komuniteti në tërësi për ti dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. Planifikimi i Zhvillimit Lokal ka të bëjë me të menduarin, të vepruarin dhe të parashikimin strategjik të veprimeve që duhet të ndërmerim në mënyrë që të realizojmë qëllimet e dëshirueshme.

Një plan zhvillimi është efektiv kur qeverisja lokale kupton se çfare po bën, kujt i shërben, dhe sa mirë i plotëson nevojat e komunitetit. Kur bëhet mirë, planifikimi i zhvillimit lokal ka pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Kjo garanton që gjate procesit po përdoren burimet më të mira të mundshme në planifikimin e së ardhmes ashtu si edhe krijon një forum të gjerë për pjesëmarrje të shoqërisë, përkushtim dhe rritje të ndjenjës së pronësisë.

Qëllimet strategjike dhe hapat e veprimit të shprehura në Planin e Zhvillimit Lokal nuk janë vetëm autoritet i qeverisjes vendore. Komuna nuk mund të bëjë vetë gjithçka, dhe as nuk mund t'i adresojë vetëm të gjitha problemet e komunitetit. Kështu që, në Planin e Zhvillimit Lokal është idea që i gjithë komuniteti ka një kontribut për të dhënë në arritjen e një komune të qëndrueshme. Angazhimi dhe veprimet e komunitetit, grupeve dhe të interesuarve të tjerë janë mjaft të rëndësishme në arritjen e suksesshme të Vizionit të Komunës, qëllimeve dhe veprimeve që janë themelore në Planet e Zhvillimit Lokal.

Një PZHL është efektiv kur në mënyrë rigoroz përdoret që të planifikojë shërbime dhe projekte, identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat financiare, të masë rezultatet e punës së qeverisë lokale, dhe t'i komunikojë këto rezultate tek komuniteti. Ky është një proces dhe dokument me anë të të cilit komuniteti mund të vërë përpara përgjegjësisë të zgjedhurit në mënyrë që ti përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të tij. PZHL siguron një përdorim efektiv të burimeve specifike të komunës në mënyrë që të bëhet sa më e mundur arritja e objektivave.

Metodologjia e FSHZH rreth Planifikimit me Pjesëmarrje të Zhvillimit Lokal përpaket të përmbushë këtë premtim. Metodologjia dhe struktura përmban parime udhëzuese, strukturën, komponentët dhe pjesëmarrësit e mëposhtem për një përjasje gjithpërfshirëse dhe fizibël të planeve të zhvillimit lokal në komuna.

Parimet Udhëzuese të Planeve të Zhvillimit Lokal në Komunitet e Shqipërisë

Plani i Zhvillimit Lokal të Komunës është

Strategjik: PZHL sheh drejt nevojave afatgjatë të një komuniteti dhe identifikon strategjinë më të mirë për t'i adresuar këto nevoja; në mënyrë strategjike vlerëson burimet, dhe shpërndarjen më të mirë të këtyre burimeve në funksion të zgjidhjes së problemeve që shqetësojnë komunitetin. Ky proces krijon midis pjesëmarrësve edhe kulturën e të menduarit në mënyrë strategjike që është një faktor i rëndësishëm për qëndrueshmëri të sukseshme.

I thjeshtë. Metodologjia dhe procesi i PZHL/MVP do të jenë të kuptueshme dhe të manaxhueshme për komunitet në lidhje me fizibilitetin, pronësinë dhe qëndrueshmërinë. Pjesëmarrës dhe Përfshirës. Proces i hartimit të PZHL/MVP, zbatimi dhe monitorimi i tij do të angazhojë një grup të gjërë nga komuna, përfshirë këtu përfaqësues nga cdo fshat, nga gratë, të rinjtë, të moshuarit, dhe grupe të tjerë vulnerabël të popullatës.

I realizueshëm. PZHL—si një plan—do të përmbajë hapa veprimi dhe projekte që janë të realizueshme. Ai do të ketë për qëllim të vendosë një balancë midis projekteve/veprimeve që mund të përfshihen në buxhetin e komunës ose të realizueshme nga komuniteti me pak përpjekje financiare dhe atyre që mund të kenë nevojë për financim të jashtëm (donatorë, grante, etj).

I koordinuar me prioritetet dhe objektivat rajonale dhe kombëtare atëherë kur ka lidhje me to. Megjithatë pikënisja për zhvillimin e një PZHL dhe fokusi i tij është komuniteti, pushteti lokal duhet t'i kushtojë vëmendje të vecantë përputhjes së PZHL me planet në nivelet më të larta. Kjo vëmendje do të sigurojë që PZHL të mos përmbajë projekte/objektiva që bien ndesh me planet rajonale apo kombëtare, por në të kundërt, t'i zhvillojnë dhe mbështesin ato.

Një mjet që *demonstron përgjegjësi, besueshmëri dhe transparencë.* PZHL duke angazhuar komunitetin në procesin e zhvillimit, jo vetëm është i detyruar që t'i përgjigjet preferencave dhe nevojave të tij por është edhe një mjet për të vënë para përgjegjësisë qeverinë lokale në kryerjen e detyrës së saj.

Komponentët e Planit të Zhvillimit Lokal të FSHZH

Një vizion i përbashkët

Komunitet shqiptarë përballen me shumë sfida për zhvillim dhe burime të pakta për t'i përballuar ato – por gjithashtu ka shumë mundësira. Detyra është t'i bashkojmë të gjitha burimet dhe komunitetin në një vizion të përbashkët për të cilin mund të mobilizohen dhe të përdorin sa më mirë burimet njerëzore, natyrore dhe financiare. Për të arritur këtë, procesi për hartimin e PZHL fton këshilltarët dhe komunitetin për "të pikturuar" të ardhmen e tyre në 10–15 vitet e ardhshme. Ky aktivitet rezulton në "Vizioni i

Komunitetit”.

Një plan për të ardhmen

E ardhmja e cdo komunitetit sigurisht që ndryshon – dhe qeverisja vendore duhet të sigurohet, që ata, me zërin e komunitetit, janë autorë të këtij ndryshimi, duke iu kundërvënë situatave që përcaktojnë të ardhmen e tyre. PZHL përmban qëllime dhe hapa veprimi të realizueshme, të cilat mund të arrihen hap pas hapi në rrugën për të përmbushur Vizionin e Komunitetit.

Katër shtyllat e zhvillimit

Metodologjia e FSHZH percakton një rrjet të gjërë në mënyrë që të siguroj që të gjitha prioritetet e zhvillimit përfshihen në PZHL. Të gjitha qëllimet strategjike dhe projektet konkrete janë të organizuara në bazë të katër fushave të mëposhtme prioritare:

Zhvillimi Ekonomik: bizneset e vogla dhe të mesme, bujqësia, industria, tregu, turizmi, marketingu dhe shërbime të tjera.

Zhvillimi Social: shendetësia, edukimi, të rinjtë, asistenca sociale, pensionet.

Infrastruktura Publike dhe Shërbimet: rrugët, furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, shërbimi i pastrimit, infrastruktura e arsimit dhe shëndetësisë.

Mirë-Qeverisje: pergjegjësia, përfshirja, informimi i publikut, besueshmëria, shërbimi ndaj ‘klientit’, menaxhimi efektiv i shërbimeve, zhvillimi organizativ me qëllim përmbushjen e qëllimve strategjike.

Një komunitet, shumë zëra

Komunitet janë të përbërë nga shumë zëra – gra, burra, femijë, të rinjë, të moshuar, biznesmenë, fermere, mesues, të papunë, grupe etnike, invalid, e kështu me radhë. Eshte kritike për qeverisjen lokale që të kuptonim shpesh se sa të ngjashme po aq dhe të ndryshme ishin nevojat dhe pritshmerite e këtyre grupeve. Proçesi i PZHL inkurajon të gjithë banorët e kominutetit të marrin pjesë ne hartimin e këtij plani dhe në zbatimin e sukseshëm të tij. Metodologjia e hartimit me pjesëmarrje e PZHL përfshin një sërë instrumentash me qëllim përmirësimin e komunikimit me publikun: Festivali i Vizionit të Komunitetit, pyestorë, dhe mbledhje publike te tjera te hartuara në mënyrë që të japin koment rreth draftit të planit (duke përfshirë mbledhje publike rreth buxhetit).

Komunikimi me publikun

Plani i Zhvillimit Lokal është një bashkëbisedim me komunitetin. Hartohet nëpërmjet marrjes së mendime dhe udhëzime nga komuniteti. Për të qënë i qëndrueshëm, PZHL kërkon që ky bashkëbisedim të jëtë i vazhdueshëm. Në metodologjinë e FSHZH, qeverisja lokale inkurajohet që të që të nxisë dialogun dhe opinionin e vazhdueshëm në mënyrë që të siguroj që puna që bëjnë ndikon ashtu siç duhet tek komuniteti

Një panoramë më e gjerë

PZHL ka të bëjë me të menduarin në terma afatgjatë në lidhje me nevojat e zhvillimit

të një lokaliteti të caktuar. Sidoqoftë, procesi i PZHL në metodologjinë e FSHZH merr parasysh edhe Strategjinë Rajonale të Zhvillimit, në mënyrë që të siguroj harmonizimin me Objektivat Rajonale dhe Kombëtare të Zhvillimit për Mijëjeçarin (OZHM).

Kush u përfshi në hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal?

Për të pasur një proces të hapur dhe transparent, në hartimin e planit për zhvillimin e komunës, është synuar një pjesëmarrje e gjerë nëpërmjet krijimit të grupeve të këshillimit me bazë pjesëmarrjen e komunitetit. Pjesëmarrja e tyre është kyç për suksesin e hartimit dhe zbatimit të PZHL.

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (grupi PZHL): Ky grup është përgjegjës për nxitjen, udhëheqjen, këshillimin dhe mbikqyrjen e hartimit të PZHL. Grupi i PZHL-së së përbëhet nga përfaqësues të këshillit, përfaqësues nga administrata e komunës, përfaqësues të fshatrave si dhe përfaqësues nga komuniteti me profesione të ndryshme. Ky grup është i ndarë në disa nëngrupe si më poshtë:

Grupi i Monitorim-Vlerësimit me Pjesëmarrje (grupi MVP): Grupi i MVP-së ngarkohet të punojë në përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të procesit të PZHL, të identifikoj treguesit për realizimin e objektivave strategjike dhe hapave të veprimit, si dhe vlerësimit të arritjeve të rezultateve. Me përfundimin e planit dhe aprovimit të tij në Këshill, grupi i MVP do të kryej monitorim të vazhdueshëm të rezultateve të PZHL.

Nënkomitetet e Fushave Prioritare: Këto nënkomitete të grupit të PZHL përfaqësojnë katër shtyllat (zhvillimi ekonomik, zhvillimi social, infrastruktura e shërbimet publike dhe qeverisja e mirë) dhe janë përgjegjëse në përcaktimin e hapave të veprimit/projektet konkrete për fushat prioritare dhe hartimin e prefizibiliteteve dhe fizibiliteteve. Këto grupe mund të ftojnë dhe specialistë të tjerë të jashtëm që të japin ekspertizën e tyre në detajimin e hapave të veprimit/projekteve konkrete.


Nëngrupe të tjera të grupit të PZHL të hartuara për të siguruar një përdorim eficient të metodologjisë , janë: nëngrupi i mobilizimit të komunitetit, nëngrupi i mbledhjes së informacionit dhe sekretariati për mbledhjen dhe mbajtjen e informacionit voluminoz që do të krijohet gjatë hartimit të planit.

Si realizohet proçesi?

Metodologjia e FSHZH përmban dhjetë hapa kyç në hartimin e planit të zhvillimit lokal.

1. **Garantimi i angazhimit lokal:** FSHZH takon Kryetarin e Komunës i cili përfton aprovimin konceptual nga Këshilli i komunës për të ecur përpara në hartimin e planit të zhvillimit.
2. **Ofrimi i asistencës:** FSHZH ofron trajnim intensiv grupit të PZHL.
3. **Fillimi i punës:** Grupi i PZHL dhe nëngrupet e tij organizojnë takime dhe caktojnë planin e aktiviteteve që do të ndjekin.
4. **Mbledhja e informacionit:** Profili i Komunës, Pyetsorë dhe një sesion strategjik në Këshill përbëjnë aktivitetet kryesore të mbledhjes së të dhënave që do të furnizojnë me informacion hartimin e planit.
5. **Mobilizimi i komunitetit:** Panairët e ideve të fshatrave organizohen në cdo fshat dhe focus grupet hartohen për grupe të vecanta.
6. **Sintetizimi i të dhënave:** Grupi i LDP analizon inputin dhe përcakton vizionin dhe qëllimet strategjike.
7. **Krijimi i planeve të veprimit për fushat prioritare:** nënkomitetet e fushave prioritare identifikojnë dhe prioritojnë projektet/hapat e veprimit si edhe kryejnë studimet e pre-fizibilitetit; Grupi i PZHL përmbledh planin.
8. **Kthimi në fshatra:** Ju folët ne ju dëgjuam, a u kuptuam drejt? Mundësi për të rishikuar draftin e PZHL me komunitetin dhe për t'u siguruar që ky plan përkon me ekspektacionet e tyre.
9. **Integrimi me proçesin e buxhetit dhe aprovimi në Këshill:** PZHL informon rreth vendimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me alokimin e burimeve dhe aprovohet nga Këshilli.
10. **Zbatimi dhe monitorim-vlerësimi i vazhdueshëm:** Grupi i PZHL fillon zbatimin e planit dhe vazhdon të monitoroj dhe vlerësoj progresin e bërë për të arritur qëllimet.

Struktura e procesit të PZHL



Cili është afati kohor për Planin e Zhvillimit Lokal?

PZHL përmban plane veprimesh afatshkurtër, të mesme dhe afatgjatë. Vizioni përfshin një periudhë kohore prej 10-15 vjetësh dhe qëllimet strategjike deri në 5 vjet. Sidoqoftë, për të qenë sa më realistë dhe të sigurt që komuniteti do të jetë në gjendje të fokusohet në projektet konkrete, hapësirën e veprimit është ngushtuar në 1-3 vjet dhe është synuar pikërisht në kohën e hartimit të buxhetit. Çdo hap veprimi ka një afat kohor për zbatim. Përputhja me këto afate kohore do të monitorohet nga grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje.

Profili i Komunës Shënkoll

Informacion i Përgjithshëm për Komunën e Shënkoll

Pozicioni gjeografik

Komuna e Shënkollit shtrihet në rrethin (qarkun) e Lezhës dhe ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë. Qarku i Lezhës kufizohet:

Veri	Shkodra dhe Puka
Lindje	Mirdita
Jug	Kruja
Përendim	Deti Adriatik


Komuna Shënkoll ndodhet në hyrje të rrethit të Lezhës, në krahun e majtë të super-stradës së veriut (kur vjen nga Tirana). Komuna shtrihet në pjesën jugore të Lezhës, 8 km larg qytetit. Komuna kufizohet nga:

Veri	Komuna Kolsh e komuna Shëngjin
Lindje	Superstrada Tiranë–Lezhë–Shkodër (dhe komuna Zejmen)
Jug	Lumi Mat
Përendim	Deti Adriatik (9 km bregdet)

Largësitë e komunës Shënkoll nga disa qendra jepen më poshtë:

Tab. 1

Distanca e Komunës Shënkoll nga disa qendra brenda dhe jashtë Shqipërisë (km).



Nga pikëpamja administrative, komuna e Shënkollit përbehej nga shtatë fshatra (Shënkoll, Gajushë, Rrilë, Tale 1, Tale 2, Barbulloj, Gryk Lumi). Aktualisht ajo përbëhet nga nënte fshatra: Shënkoll, Gajushë, Rrilë, Tale 1, Tale 2, Alk, Barbulloj, Gryk Lumi 1 dhe Gryk Lumi 2. Tokat bujqësore të komunës Shënkoll janë shumë pjellore dhe të përshtatshme për zhvillimin bujqësor e blegtoral. Komuna ka një klimë të mrekullueshme, me burime ujore dhe ujë të pijshëm, me të gjithë fshatrat që ndodhen shumë pranë detit si dhe pranë lumit Mat. Në përputhje me kushtet klimatike tokësore e tradicionale në këtë komunë kultivohen kryesisht kulturat perimore, bostanore, fasule, patate, fruta, foragjere si dhe mbarështohen lopë, derra, të imta, shpend, bletë e tjerë.

Pozicioni gjeografik krejtësisht fushor i vendosjes së fshatrave, kushtet klimatike të një zonë mesdhetare, cilesia mjaft e mirë e tokave dhe shtrirja territoriale e komunës (e quajtur fusha e Bregut të Matës), e kufizuar gjatë gjithë vijës kufitare në përendim me detin Adriatik dhe në jug me lumin Mat, i japin kësaj zonë resurse të mëdha për zhvillimin e turizmit, bujqësisë, blegtorisë (rritja e të gjitha llojeve të kafshëve e shpendëve) si dhe zhvillimit të peshkimit. Infrastruktura rurale në këtë komunë është përmirësuar dhe ndihmon në zhvillimin social-ekonomik të zonës.

Komuna Shënkoll është ndër komunat me të mëdha të Qarkut të Lezhes. Në Shtator 2008, ajo numëron një popullësi prej 14,423 banorësh, me 2,839 familje dhe me 1,973 fermerë.

1. SHOQËRIA (KAPITALI SOCIAL)

a. Komuniteti dhe Dinamika e tyre

Popullata autoktone që përfshihet në Komunën e Shënkollit kryesisht është vendosur në këtë vend prej dhjetra dekadash. Mbas ndryshimeve të ndodhura në fillim të viteve 1990, dhe kryesisht pas krijimit të komunës me 1992, numri i popullsisë u shtua me të ardhur nga zonat malore përreth. Në 1992 krijohet komuna e Shënkollit me 8 fshatra dhe me rreth 5,000 banorë. Pas vitit 1994, vazhduan ardhjet me të mëdha të banorëve të rinj, të cilët kryesisht vinin nga zona verilindore e vendit (rrethi i Pukës dhe i rrethi i Mirditës). Popullata e sotme është e përzier: ka banore autoktonë, të cilët janë malësor të ardhur rreth 100 vjet më parë (kryesisht nga malësia e Mbi Shkodrës) dhe popullatë e ardhur rishtas me lëvizjet e mëdha demografike të ndodhura pas vitit 1992.

Megjithatë, mund të thuhet së traditat e popullatës së kësaj zone janë në përgjithësi ato të trevave veriore dhe veri lindore të Shqipërisë. Megjithëse popullata është heterogjene, sidomos në Shënkoll, duhet të theksohet se, ajo është shumë kompakte dhe me një unitet shumë të mirë ndërmjet banorëve. Midis familjeve dhe banorëve të fshatrave të komunës ekziston një mirëkuptim, harmoni dhe bashkëpunim.

Popullsia e Komunës Shënkoll (Shtator 2008)**Tab. 2**


Nr.	Fshati	Banorë			Familje
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	
1.	Shënkoll	2.117	1,801	3,918	751
2.	Gajushë	311	318	629	172
3.	Rrile	941	960	1,901	371
4.	Tale 1	509	473	982	209
5.	Tale 2	322	308	630	209
6.	Alk	182	168	350	
7.	Barbulloj	1,678	1,796	3,474	713
8.	Gryk Lumi 1	365	355	720	414
9.	Gryk Lumi 2	917	902	1,819	
KOMUNA		7,342	7,081	14,423	2,839

b. Arsimimi

Komuna Shënkoll i ka kushtuar një vëmendje të veçantë mbështetjes dhe financimit të arsimit, duke plotësuar infrastrukturën e nevojshme arsimore për zhvillimin normal të arsimit.

Në komunën tonë janë katër shkolla 9-vjeçare, ku mësojnë 2042 nxënës si dhe një shkollë e mesme gjimnaz që frekuentohet nga 254 nxënës. Numri total i mësueve që japin mësim arrin 123. Njëkohësisht janë edhe tetë kopshte fëmijësh. Shtimi i vazhdueshëm i popullsisë bëri të domosdoshëm edhe shtimin e shkollave dhe rikonstrukcionin e atyre ekzistuese, për rrjedhojë u ndërtua shkolla 9-vjeçare në fshatin Grykë Lumi 2 në vitin 2002, ndërsa në vitin 2007-2008 u ndërtua godina e re dhe u bë rikonstrukcioni i shkollës së mesme të bashkuar në Shënkoll. Siç shihet edhe nga grafiku nr.1 48% e popullatës së intervistuar shprehen se janë shumë të kënaqur/të kënaqur me gjendjen e kopshteve, ndërsa 61% për gjendjen e shkollave. Këto përqindje mbështesin atë të pothuajse të gjitha shkollat nëpër fshatra janë rikonstruktuar dhe ndodhen në gjendje të mirë pune.

Fig. 1 - Kënaqshmëria e komunitetit në lidhje me gjendjen e kopshteve dhe shkollave




c. Kultura dhe Koha e Lirë

Komuna Shënkoll ka qenë një qendër e rëndësishme e kulturës dhe me një trashëgimi të pasur kulturore. Përpara viteve '90-të në fshatin Shënkoll ka funksionuar shumë mirë Pallati i Kulturës ku zhvilloheshin aktivitete të ndryshme kulturore. Në vitin 2008 në bashkëpunim me FSHZH në fshatin Shënkoll është ndërtuar Qendra Komunitare ku po kryhen aktivitete të ndryshme me rininë dhe moshën e tretë.

Gjithashtu në dispozicion të komunitetit janë edhe tre terene sportive (fusha futbollit) të cilat përdoren nga të rinjtë për aktivitete sportive. Edhe pse janë të tilla mundësira të kalimit të kohës së lirë, ende mund të thuhet se jeta kulturore dhe sportive është e varfër. Këtu e tregojnë edhe përqindjet e larta në pakënaqshmëritë e banorëve në grafikun nr. 2.

Fig. 2 - Kënaqshmëria e banorëve me kulturën dhe kohën e lirë



d. Shërbimi Shëndetësor


Shërbimi në Komunën Shënkoll, realizohet nëpërmjet strukturave të shërbimit shëndetësor parësor. Sistemi shëndetësor përbëhet nga 1 qendër shëndetësore dhe 7 ambulanca ku punojnë 6 mjekë të familjes dhe 13 mami/infermiere.

Komuna Shënkoll i ka kushtuar një vëmendje të veçantë përmirësimit të shërbimit shëndetësor ku vlen të theksohet ndërtimi i 5 ambulancave dhe duke mbuluar këtë shërbim në çdo fshat të komunës. Në kuadër të përmirësimit të këtij shërbimi me shumë duhet bërë në kualifikimin e personelit sidomos atij të mesëm, paisjen e ambulancave me mjete të nevojshme dhe sidomos me ilaçe. Gjithashtu kërkohet që ky shërbim të jetë 24 orë.

Përsa i përket higjenes në komunë funksionon shërbimi i pastrimit nga firma private për tre fshatra: Shënkoll, Rrilë, dhe Barbullojë ku janë vendosur 60 kontenierë. Me ndërtimin e aksit rrugor do të përfshihen në këtë skemë pastrimi edhe fshatrat Tale dhe Grykë Lumi. Nga anketimi i realizuar në muajin korrik 2008, te grafiku i mëposhtëm,

rezultoni se banorët shprehen 55% shumë të kënaqur/të kënaqur për kushtet e qendrave shëndetësore dhe 51% për pastërtinë e fshatit.

Fig. 3 - Kënaqshmëria e banorëve me Q. Shëndetësore dhe pastërtinë




e. Asistenca Sociale

Ka dy kategori familjesh që përfitojnë asistencë sociale: familje pa të ardhura dhe familje me të ardhura më të vogla se niveli i jetesës.



Në Komunën Shënkoll trajtohen me asistencë sociale 177 familje, me 895 banorë, rreth 6% e popullsisë. Këto familje janë kryesisht familje të ardhura nga zonat verilindore dhe që nuk janë përfshirë nga reforma e tokës. Ato janë të vendosur në fshatin Grykë Lumi 2. Po mendohen forma të reja të ndihmës së këtyre familjeve nëpërmjet përdorimit të fondeve sociale duke i aktivizuar keto individë në punë të ndryshme publike

Fig. 4 - Numri i familjeve me asistencë sociale sipas fshatrave



f. Cilësia e Jetës

Në komunën Shënkoll jetohe mirë. Cilësia e mirë e jetesës vjen si rezultat i emigracionit që është burimi kryesor i të ardhurave si dhe nga zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë në komunë. Shërbimi i furnizimit me ujë është zgjidhur në menyrë individuale për çdo familje si dhe ekziston një sistem rrugor i cili kenaq pjesën më të madhe të nevojave e të komunës. Fig. 5 tregon përqindje pothuajse të përafërt banorësh që vlerësojnë cilësinë e jetesës shumë të mirë/të mirë (48 %) dhe që e vlerësojnë të varfër/shumë të varfër (45 %).



62% e banorëve raportojnë së cilësia e jetesës në komunë është përmirësuar disi dhe 7 % është përmirësuar shumë. Këto shifra janë një tregues optimist i cilësisë së jetesës në komunë.

2. EKONOMIA

a. Situata e Përgjithshme

Bujqësia dhe blegtoria janë aktivitetet kryesore ekonomike që zhvillohen në komunën e Shënkollit. Sektori i industrisë është kryesisht i lidhur me përpunimin e mermerit që nxirret nga kodrat e Treshit (komuna Zejmen) dhe të materialeve inerte të nxjerra nga lumi Mat. Ky sektor, sektori i agropërpunimit dhe disa biznese në fushën e përpunimit të drurit mund të zhvillohen gradualisht në të ardhmen e afërt. Biznesi i vogël me bazë profesionin përfaqësohet shumë pak. Duket mungesa e shërbimeve në sektorë të ndryshëm si dhe, ka fshatra të komunës ku ky biznes nuk është i përfaqësuar pothuajse fare.

Megjithëse vitet e fundit ka pasur një zhvillim, komuniteti përsëri nuk është shumë i kënaqur me situatën aktuale të zhvillimit ekonomik të komunës. Komuna e Shënkollit ka disa faktorë të rëndësishëm, të cilat ajo mund t'i përdore për të nxitur zhvillimin e biznesit. Në këta faktorë mund të rendisim pozicionin e saj të favorshëm gjeografik, tokën pjellore, burime të tjera natyrore dhe, mbi të gjitha plazhet e saj të pashfrytëzuara ende. Një faktor tjetër i rëndësishëm është edhe eksperiencia e vyer e banorëve të saj. Nga ana tjetër, komuna ka më shumë se 50% të popullsisë së saj aktive përpunë, ka lehtësi për të dalë në superstradën e veriut, si dhe mundësi jashtëzakonisht të mëdha për të zhvilluar turizmin bregdetar dhe agroturizmin. Të gjitha këto janë faktorë që do të ndikojnë drejtpërsëdrejti dhe fuqimisht në zhvillimin ekonomik të komunës.

Aktivitetet kryesore që aktualisht zhvillohen në komunë janë: bujqësia, blegtoria, industria, agropërpunimi, shfrytëzimi burimeve natyrore e ndërtimi, tregtia dhe shërbime (përfshirë edhe transportin). Megjithatë, ekziston një mendim i përgjithshëm për prioritetin kryesor të zhvillimit ekonomik që ka të bëjë me zhvillimi i turizmit bregdetar dhe i agroturizmit; zhvillimi bujqësisë dhe zhvillimi blegtorisë.

Por, prioritet i zhvillimit ekonomik të komunës mbeten edhe zhvillimi i agroindustrisë dhe i biznesit të vogël.

b. Bujqësia

Një ndër faktorët kryesorë që do të ndikojë në përmirsimin e përgjithshëm ekonomik dhe zhvillimin e bizneseve në komunë, është sektori i bujqësisë. Komuna e Shënkollit përfshihet në një rajon që është shumë i njohur për tokat e saj të pasura dhe pjellore si dhe për eksperiencën e fermerëve të saj në punët e bujqësisë.

Komuna e Shënkollit ka drejtim agroturistik. Mirë menaxhimi i plazheve, përmirësimi i shërbimeve për plazhistët, rritja e shkallës së higjenës ka sjellë rritjen e të ardhurave të banorëve dhe të vet komunës. Toka pjellore, klima e favorshme, organizimi i mirë i fermës dhe eksperiencia e gjatë e fermerëve në bujqësi ka sjellë rritjen e prodhimeve të perimeve, bostanit, patateve, fasuleve të vreshtarisë për rrush tavoline dhe të frutikuturës. Shtimi i prodhimeve bujqësore është shoqëruar me rritjen e aktivitetit agroturistik dhe

shtimin e pikave të grumbullim përpunimit.

Komuna e Shënkollit ka një sipërfaqe të tokës bujqësore are prej rreth 2,952.7 ha të ndarë sipas fshatrave sipas Tabelës 4.

Toka bujqësore arë në komunë

Tab. 4

Nr.	Fshati	Njesi	Sasi
1.	Shënkoll	ha	748.40
2.	Gajushë	ha	169.30
3.	Rrile	ha	370.00
4.	Tale 1	ha	258.25
5.	Tale 2	ha	178.94
6.	Alk	ha	85.80
7.	Barbulloj	ha	464.92
8.	Gryk Lumi 1	ha	617.39
9.	Gryk Lumi 2	ha	59.70
KOMUNA		HA	2,952.70

Burimi: FSHZH: Paketa Informative e Komunës Shënkoll

Prodhimet kryesore bujqësore të komunës janë të grupuara në tabelën e mëposhtme (shih Tab. 5).

Prodhime bujqësore të komunës Shënkoll

Tab. 5

Nr.	Fshati	Drithëra (ton)		Produkte bujqësore (ton)			Fruta* (ton)	Rrush* (ton)
		Grure	Misër	Ndryshme	Patate	Fasule		
1.	Shënkoll	895.60	673.40	---	48.50	25.50	---	---
2.	Gajushë	180.60	112.00	---	38.80	11.30	---	---
3.	Rrile	388.50	224.70	---	18.60	5.10	---	---
4.	Barbulloj	743.40	426.10	---	26.40	21.20	---	---
5.	Tale 1	217.30	117.30	---	8.70	6.20	---	---
6.	Tale 2	126.00	82.00	---	3.00	3.70	---	---
7.	Alk	70.70	30.20	---	3.20	2.07	---	---
8.	Gryk Lumi 1	318.40	18.30		29.10	7.20		
9.	Gryk Lumi 2	110.00	78.30		7.00	6.30		
KOMUNA		3,050.50	1,762.30	41,400.00*	183.00	89.00	355.00*	588.00*

Burimi: FSHZH: Paketa Informative e Komunës Shënkoll

*DRBUMK, Lezhe

Kultivimi i fasules varion në 70-90 ha. Fermerët po rrisin sipërfaqet e mbjella, sepse ky prodhim ka gjetur treg më të mirë si dhe është më me rendiment se kulturat përimore e bostani. Këto dy vitet e fundit, ka filluar shtimi i sipërfaqes me pemtore, kryesisht të specit Kivi. Kjo specie ka përshtatshmëri klimatike si rezultat i lagështisë ajrore të lartë të zonës (nga lumi Mat deri në det), dhe kushtet tokësore të mira për këtë kulturë. Në fundmi, në fshatrat e komunës, ka gjetur shtrirje edhe kultivimi i agrumeve, jo vetëm si bimë dekorative, por edhe për prodhim. Në komunë funksionon një qendër prodhimi fidanash frutore me kapacitet 20-30 mijë fidana në vit. Kjo fidanishte furnizon tregun dhe fermerët e zonës në shtimin e sipërfaqeve të mbjella me drufrutore.

Niveli i prodhimit për ha është i ulët si për perimet, pataten, bostanin, fasulen, dhe foragjeret. Kjo vjen si rezultat i mungesës së shërbimeve, sidomos në mekanizim e ujitjes dhe nga pamundësia e përdorimit të fuqisë punëtore. Një shkak tjetër është edhe mos aplikimi i teknologjive bashkëkohore (mungesa e mjeteve mekanike; mos pasja mundësi e realizimit të ujitjes me pika për të ushqyer bimët, etj.). Sistemi i madh kullues është i zgjidhur me KK1 e KK2 së bashku me Hidrovorin e Tales, por problematik është rrjeti i dytë e i tretë kullues e në përgjithësi sistemi ujitës i parehabilituar. Në komunën Shënkoll për vitet 2007-2008 Qeveria Shqiptare ka financuar me subvencionim mbjelljen e kulturave drufrutore dhe për këto vite kanë aplikuar e fituar financimin edhe fermerë të kësaj komune (shih tabelën Tab.6). Kjo politikë do të vazhdojë dhe për vitet në vazhdim.

Financime të qeverisë në dru-frutore për vitin 2007 - 2008

Tab. 6

Nr.	Kulturat	Numri i fermerëve	Sipërfaqe (ha)	Vlera (Lek)
1.	Vreshta	6	3.40	1,700,000.00
2.	Pemtore	20	19.40	6,790,000.00
3.	Ullinj	2	2.15	752,000.00
SHUMA		28	24.95	9,242,000.00

Burimi DRBUMK, Lezhe

Mekanika bujqësore plotëson pjesërisht nevojat e fermerëve në zbatimin e hallkave teknologjike për kultivimin e kulturave bujqësore. Në komunë, aktualisht disponohen 58 traktorë me rrota, 25 minitraktorë, 22 makina mbjellëse, 23 motokorrëse, 5 autokombajna e 30 freza. Një pjesë e këtyre mjeteve janë të amortizuara e jo të paisura me agregatet e nevojshme, si për plugimin, nivelimin, shpërndarjen e plehrave, mbjelljen, deri tek procesi i korrjes e përpunimit të produkteve bujqësore e atyre foragjere për blegtorinë.

Megjithatë, në këtë komunitet ka disa fermerë që kanë investuar në bujqësi e blegtori për zhvillimin e fermave të tyre, duke siguruar prodhime për treg.

c. Blegtoria

Në komunën e Shënkollit mbarështohen pothuajse të gjithë llojet dhe kategoritë e kafshëve. Në komunë mbarështohen mesatarisht 1.3 krerë gjedh, 1 krerë lopë, 1.5 të imëta, 2.6 derra, 7.0 shpend për familje si dhe prodhohet 2,366 kv qumësht e 218.5 kv mish për 100 ha tokë are, ose 499 kg qumësht e 46 kg mish për fryme. Kjo ka krijuar mundësitë për të dalë në treg me produkte blegtorale, duke krijuar kështu një burim të ardhurash për familjet e zonës nga ky “bisnes i vogël dhe mesëm blegtoral”.

Të dhëna mbi blegtorinë në komunën Shënkoll

Tab. 7

Nr.	Fshati	Të imëta		Gjedhe	Shpend	Derra*	Bletë*	Një* Thundr
		Dhen	Te dhirta					
1.	Njësia Shënkoll	Krerë 300	Krerë 65	Krerë 900	Krerë 4,000	Krerë n/a	Koshere n/a	Krerë n/a
2.	Gajushë	250		200	3,500	n/a	n/a	n/a
3.	Rrile	300		460	7,200	n/a	n/a	n/a
4.	Tale 1	150	25	120	600	n/a	n/a	n/a
5.	Tale 2 +	750	390	610	4,000	n/a	n/a	n/a
6.	Alk							
7.	Barbulloj	600	80	650	500	n/a	n/a	n/a
8.	Gryk Lumi 1	330	55	500	2,000	n/a	n/a	n/a
9.	Gryk Lumi 2	400	505	400	800	n/a	n/a	n/a
KOMUNA		3,080	1,120	3,840	22,600	7,500	300	25

Burimi: FSHZH: Paketa Informative e Komunës Shënkoll

* DRBUMK Lezhë

Mesatarja e tokës bujqësore për familje është 1.02 ha, ose 1.5 ha për çdo ferme. Fermat kryesisht janë mikse, bujqësore e blegtorale, me lloje të ndryshme të kafshëve.

Ka tendenca drejt specializimit, por akoma nuk dominojnë fermat e specializuara në drejtim të prodhimit. Në nivel komunë ka 1 410 ferma me nga 1-5 krerë me lopë, 35 ferma me 6-10 krerë dhe 5 ferma me mbi 10 krerë lopë me tregues të mirë gjenetik e racor. Në përbërjen racore dominojnë lopët e racës Holshtejn, Simentale Xhers dhe kryqëzimet e tyre. Këto përbëjnë dhe bazën me potencial të lartë të prodhimit të qumështit e mishit. Në komunë funksionojnë 3 stacione të insiminimit artificial të gjedhit, të cilat mbulojnë të gjithë zonën. Në këto stacione aplikohet me sukses përmirësimi racor me raca të pastra me drejtim prodhim qumështi, të dyfishtë dhe me raca mishatake. Në disa ferma aplikohet edhe kryqëzimi industrial për prodhim mishi (me racat Limuzinë, Sharole, Blu-Belge etj.).

Prodhimi mishit në komunën Shënkoll Tab. 8

Nr.	Emertimi	Prodh./ton
1.	Gjedhi	240.00
2.	Derri	360.00
3.	Të imëta	37.00
4.	Shpendë	15.00
Mish gjithsej		652.00

Burimi: DRBUMK Lezhë

Komuna ka 230 ferma me mbi 20 krerë të imëta, 52 ferma me 20-50 krerë e 14 ferma me 50 - 100 krerë të imëta. Meqënëse është krejtësisht zonë fushore, trajtimi i dhive është i kufizuar. Mbarështohen dhi të racave të përmirsuara me rendiment të lartë për qumësht, duke shfrytëzuar kullotjen në kulturat foragjere dhe pas kulturave bujqësore. Kjo bëhet kryesisht me mbarështim gjysmë stallor. Qendra e Përpunimit të qumështit në Shënkoll vazhdon të funksionojë. Por, meqënëse zona përshkohet me rrugë të asfaltura (është pranë superstradës Lezhë –Tiranë, rruga Shënkoll Tale, Rrilë – Shënkoll etj.), krijohen mundësi dhe lehtësira që qumështi të grumbullohet e të tregtohet në qytetet e Milotit, Rrëshenit, Rubikut, Laçit e Tiranës.

Prodhimi i qumështit në komunën Shënkoll Tab. 9

Nr.	Lloji	Nr. krerëve	Rend.Kg/krerë	Prodh./ton
1.	Lopë	2,840.00	2,400.00	6,816.00
2.	Dele	2,260.00	70.00	158.00
3.	Dhi	740.00	118.90	88.00
Qumësht gjithsej				7,062.00

Burimi: DRBUMK Lezhë

Zona ka traditë shumë të mirë në mbarështimin e derrit. Ka mbi 1,500 ferma të vogla me 1-5 krerë, 200 ferma me 6-10 krerë, 80 ferma me 1-20 krerë, 120 ferma me 21-50 krerë dhe është në përfundim një kompleks blegtoral me kapacitet 100 krerë dosa prodhimi. Rendimentet e prodhimit blegtoral janë me të larta në raport me mesataren e komunave të tjera të rrethit. Nga 1,990 litra niveli i rrethit, merren mbi 2,400 litra për lope, në ferma të vecanta mbi 4,500 litra qumësht për lope, merren 70 litra qumësht për dele e 150 litra për dhi. Struktura e prodhimit të qumështit: Realizohet nga lopet 96%, 2.5% nga delet e 1.5% nga dhite. Struktura e prodhimit mishit është: 38 % nga gjedhi, 55.0% nga derri, 5.6% nga të imtat e 2.3% nga shpendi.

Ndonëse janë 3 qendra të majmerisë gjedhit, peshat e therjes së viçave janë të ulëta, 120 kg mesatarisht për krerë.

Prodhimi vezëve dhe mjaltit në komunën Shënkoll

Tab. 10

Nr.	Emërtimi	Njësia	Prodh./ton
1.	Vezë	000/kokrra	8,500.00
2.	Mjalti	Ton	6.00

Burimi: DRBUMK Lezhë

d. Agropërpunimi

Komuna e Shënkollit ofron mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e agroindustrisë dhe të agro-turizmit. Burimet më të mëdha dhe potencialisht të shfrytëzueshme që ofron kjo komunë janë në drejtim të sektorit të përpunimit të frutave dhe në atë të përpunimit të prodhimeve blegtorale. Mbas sektorit të bujqësisë dhe atij të blegtorisë, zhvillimi i agroindustrisë përbën një tjetër prioritet, drejtim i cili mund dhe duhet, të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të komunës.

Linja të përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale janë të pakta. Ndjehet nevoja për ngritjen e qendrave të përpunimit të qumështit, përpunimit të frutave, përimeve, etj. Një nxitje për zhvillimin e këtyre qendrave, përveç mundësive të mëdha për prodhimin e këtyre produkteve në komunë, janë dhe nevojat në rritje të vetë komunitetit, nevojat e pushuesve gjatë sezonit të plazhit dhe ato të tregut në Lezhë e Milot.

Aktualisht në komunë funksionojnë pesë biznese të fushës së agropërpunimit: 2 subjekte prodhim buke, 2 subjekte peshkimi dhe 1 subjekt për prodhim e tregtim mishi.

e. Shfrytëzimi burimeve natyrore e ndërtimi

Përveç sektorit të bujqësisë, blegtorisë, turizmit dhe agroturizmit, një sektor tjetër me mundësi të mëdha për të kontribuar drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm, është edhe sektori i shfrytëzimit të burimeve natyrore të komunës.

Në Komunën e Shënkollit zhvillojnë aktivitetin e tyre 11 subjekte në këtë fushë. Nga këto, 3 subjekte merren me përpunimin e mermerit. Mermer nxirret në kufi të komunës, në fshatin Tresh të komunës së Zejmenit. Depozitimi i mermerit në Tresh përfaqësohet nga mermer i tipit "marbled limestone" në ngjyrë gri, të kuqe dhe me variacione (motley) në ngjyrë. Rezerva në Tresh vlerësohet në 13,000,000 ton.

Gjithashtu në komunë zhvillojnë aktivitetin e tyre 5 subjekte për nxjerrjen dhe përpunimin e inerteve dhe të betonit: 3 janë kompani përpunimi inertesh, 2 janë kompani për

prodhim betoni. Një kompani ka aktivitet në fushën e çpimit për nxjerrjen e ujit. Aktualisht në komunë zhvillojnë aktivitetin e tyre: 1 subjekt për përpunim druri dhe 1 subjekt për prodhimin e objekteve prej duralumini. Përpunimi lëndës drusore dhe prodhimi i produkteve prej duralumini realizohet nga dhe për banoret e komunës.

f. Tregtia

Në komunën e Shënkollit zhvillojnë aktivitetin e tyre 27 subjekte në fushën e tregëtisë. Nga këto:

- 16 subjekte merren me tregtinë e mallrave me pakicë (artikuj të ndryshëm dhe ushqimor);
- 5 subjekte merren me tregtinë e karburanteve;
- 1 subjekt merret me tregtinë e inputeve bujqësore;
- 4 subjekte shesin materiale ndërtimi me pakicë, dhe
- 1 subjekt ka farmaci bujqësore.

g. Shërbimet dhe transporti

Në Komunën e Shënkollit zhvillojnë aktivitetin e tyre 36 subjekte në fushën e shërbimeve dhe të transportit. Shërbimet janë kryesisht në drejtim të bar/restorant – bufeve, të cilat ndodhen në pothuaj të gjitha fshatrat e komunës.

Shërbimet aktuale në komunë i kemi kategorizuar si më poshtë:

Bar-Bufe	10 subjekte;
Bar-Restorant	11 subjekte;
Profesione	5 subjekte;
Kohë e lirë (sport)	1 subjekte;
Turizëm familjar	1 subjekt;
Shërbim funeralesh	1 subjekt;
Transport udhëtarësh	6 subjekte;
Transport inertesh	1 subjekt.

Aktiviteti bar-bufe dhe bar-restorante është i përqëndruar kryesisht në Shënkoll (9) dhe në superstradë (4). Në këto aktivitete të punësuarit janë punonjës nga zona.

Biznesi i organizimit të kalimit të kohës së lirë (sport) përfaqësohet vetëm nga një subjekt në Shënkoll. Me aktivitetin e transportit merren 7 subjekte: 6 me transport udhëtarësh (5 mjete 8+1 dhe 1 mjet 3+1) dhe 1 subjekt me transport inertesh (në Zejmen dhe Treshë. Të katër këta subjekte janë persona fizik (biznes i vogël). Në këto subjekte të vetëpunësuarit janë nga fshatrat e zonës.

Profesionet që ushtrohen në komunë janë: gomist, servis makinash, punime hekuri, autoshkollë.

3. MJEDISI DHE INFRASTRUKTURA

a. Pozita Gjeografike e Komunës

Aktualisht komuna përbëhet nga nëntë fshatra: Shënkoll, Gajushë, Rrile, Tale 1, Tale 2, Alk, Barbulloj, Gryk Lumi 1 dhe Gryk Lumi 2. Tokat bujqësore të komunës Shënkoll janë shumë pjellore dhe të përshtateshme për zhvillimin bujqësor e blegtoral. Komuna ka një klimë të mrekullueshme, me burime ujore dhe ujë të pijshëm, me të gjithë fshatrat që ndodhen shumë pranë detit si dhe pranë lumit Mat. Në përputhje me kushtet klimatike tokësore e tradicionale në këtë komunë kultivohen kryesisht kulturat përimore, bostanore, fasule, patate, fruta, foragjere si dhe mbarështohen lopë, derra, të imëta, shpend, bletë e tjerë.

b. Burimet Natyrore

Pozicioni gjeografik krejtësisht fushor i vendosjes së fshatrave, kushtet klimatike të nje zone mesdhetare, cilësia mjaft e mirë e tokave dhe shtrirja territoriale e komunës (e quajtur fusha e Bregut të Mates) e kufizuar gjatë gjithë vijës kufitare në Perëndim me detin Adriatik dhe në Jug me lumin Mat, i japin kësaj zone resurse të mëdha për zhvillimin e turizmit, bujqësisë, blegtorisë (rritja e të gjitha llojeve të kafshëve e shpendëve) si dhe zhvillimit të peshkimit. Infrastruktura rurale në këtë komunë është përmirësuar dhe ndihmon në zhvillimin social ekonomik të zonës.

c. Toka

Tokat kanë tregues të mirë agropedologjik, ku 77.5 % e ngastrave kanë bonitet të klasit të dytë e tretë. Nga informacionet e marra në DRBU Lezhë, sipërfaqja e tokës bujqësore është 3,022 ha, nga e cila tokë are 2,952.70 ha. Frutikultura 37,4 ha. Aktualisht, tokë e punueshme është 2,187.4 ha, ose 74.08 %. Pjesa tjetër prej 765.30 ha (25.92 %) është tokë djerre. Komuna ka mesatarisht 0.2 ha tokë për frymë, 1.02 ha për familje dhe 1.5 ha për çdo ferme. Blegtoria është e zhvilluar me gjedh 3,840 krerë, derra 7,500 krerë, të imëta 4,200 krerë e shpend 22,600 krerë.

Komuna Shënkoll është ndër komunat më të mëdha të Qarkut të Lezhës. Në Shtator 2008, ajo ka një popullsi prej 14,423 banorësh, me 2,839 familje dhe me 1,973 fermerë.

d. Klima

Treguesi		Sasia
*	Temperatura mesatare vjetore:	15.00°C
*	Temperatura mesatare në Janar:	7.00°C
*	Temperatura mesatare në Korrik:	24.00-25.00°C
*	Temperatura më e lartë e regjistruar	41.30°C
*	Temperatura mesatare vjetore (Gusht 1982)	15.30°C
*	Temperatura më e ulët e regjistruar (Janar 1962)	-8.00°C
*	Sasia e shiut vjetor	1,400-1,600 mm
*	Mesatare e ditëve me diell në vit	320-332 ditë
*	Mesatare e orëve me diell në vit	2,550 orë
*	Muaji më me diell në vit	Korrik

Burimi: Bashkia Lezhë

Klima në Komunën e Shënkollit është tipike Mesdhetare: verë e nxehtë (jo shumë e thatë) dhe dimër i butë dhe i lagësht. Një ndikim të madh në klimën e komunës ka deti Adriatik, i cili është rreth 4 km larg. Mesatarja e rreshjeve të shiut në vit është në rreth 1,431 mm (sipas informacionit të DRBUMK, Lezhë). Temperaturat më të ulta janë në Janar (-2°C deri -3°C) e më të lartat janë në Korrik (deri në 36°C). Më poshtë jepen të dhëna mbi vlerat mesatare stinore të parametrave kryesore klimaterike për rrethin e Lezhës :

Vlera e parametrave klimaterike mesatar stinor në rrethin e Lezhës

Tab. 12

Parametri	Pranverë	Verë	Vjeshtë	Dimër
* Temperature mesatare (°C)	15	24	20	9
* Lagështia mesatare (%)	60	59	67	55
* Sasia mesatare e shiut (mm)	107	116	461	574

Burimi: Bashkia Lezhë

e. Shfrytëzimi burimeve natyrore

Në territorin e komunës zhvillojnë aktivitetin e tyre 5 subjekte për nxjerrjen dhe përpunimin e inerteve dhe të betonit: 3 janë kompani përpunimi inertesh, 2 janë kompani për prodhim betoni. Një kompani ka aktivitet në fushën e çpimit për nxjerrjen e ujit. Aktualisht në komunë zhvillojnë aktivitetin e tyre: 1 subjekt për përpunim druri dhe

1 subjekt për prodhimin e objekteve prej duralumini. Përpunimi lëndës drusore dhe prodhimi i produkteve prej duralumini realizohet nga dhe për banoret e komunës.

f. Shfrytëzimi inerteve në lumin Mat

Rrjedhja e poshtme e lumit Mat fillon poshtë digës së Hidroçentralit të Shkopetit me kuote 38 m dhe derdhet në detin Adriatik duke patur një gjerësi të shtratit aluvial rreth 1000-1200 m. Prurja mesatare vjetore në grykëderdhjen në det është 103 m³ ujë/sek. Ndërsa prurjet e ngurta llogariten në 2 milion m³ në vit.

Sipas një studimi të bërë nga QKZH Tiranë, materiali inert përgjithësisht përfaqësohet nga zhavorrë kokër mesëm - kokër trashë me mbushje rëre. Në sektorin Skuraj-Tale, në vitin 1982-1983 janë kryer 258 shpime me thellësi nga 3.3 deri në 23.2 m në një gjatësi prej 8 km dhe me gjerësi mesatare 765 m. Nga analizat e kryera mbi cilësinë e materialeve inerte rezulton së ato janë brenda standarteve shtetërore të miratuara. Përbërja granulometrike në këtë sektor jepet nga tabela e mëposhtme:

Përbërja granulometrike e aluvionëve në Skuraj-Tale

Tab. 13

Zaje me madhësi	mbi 80 mm (popla)	40-80 mm (popla)	20-40 mm (zhavor)	10-20 mm (zhavor)	5-10 mm (zhur)	nën 5 mm (Rërë)	Argjile*
Përberja	0.58 %	13.54 %	20.94 %	15.37%	17.89 %	34.7 %	< 4 %
* kjo e përfshire në përbërjen e rerës së imët							

Burimi: "Përdorimi i burimeve natyrore të reja për përfitimin e gurit qëllqëror për nevojat e sektorit të ndërtimit dhe infrastrukturës është domosdoshmëri dhe prioritet për ruajtjen e ambientit", QKZH, Tiranë, 30.10.2006

Në objektet e studiuara nga Shërbimi Gjeologjik është llogaritur që rezerva e inerteve në sektorin Skuraj-Tale është 77,000,000 m³ ose 131.600.000 Ton.

Në lumin e Matit nga pika e bashkimit të tij me lumin e Fanit deri në afërsi të derdhjes së tij në det, në një sektor me gjatësi 16 km dhe gjerësi mesatare 915 m ushtrojnë aktivitetin (me impjante fraksionimi të instaluara) 10 subjekte private nga të cilat 4 në krahun e majtë dhe 6 në krahun e djathtë. Sipas studimit të mësipërm, kompanitë e inerteve me vendndodhje në komunën Shënkoll dhe me leje shfrytëzimi të miratuar për 5 vjet (regjistruar deri në Tetor 2006) janë:

Firma "NATOJA": Shfrytëzon një shesh prej 0.307 km². Rezerva të llogaritura rreth 830,000 m³ dhe kapacitet 80,000 m³. Prodhon Granil 1 (rreth 16,000 m³), Granil 2mm (rreth 18,000 m³), rërë (rreth 46,000 m³).

Firma "SIDRIT": Shfrytëzon një shesh prej 0.075 km². Rezeva rreth 373,200 m³ dhe

kapacitet 20,000 m³. Prodhon Granil 2 mm (rreth 7,800 m³) dhe rërë (rreth 12,200 m³). Firma "DOCI": Shfrytëzon një shesh prej 0.118 km². Rezerva të llogaritura rreth 138,633 m³ dhe kapacitet 12,000 m³. Prodhon Granil 1 (rreth 3,600 m³), Granil 2 mm (rreth 2,200 m³) dhe rërë (rreth 6,200 m³).

Në basenin e Matit ekzistojnë mundësitë për zëvendësimin e inerteve lumore, me inerte të nxjerrë nga shfrytëzimi i shkëmbinjeve karbonate me kariera. Këto shkëmbinj gjenden në fshatrat Lisën, në Spiten, Manati, Zejmen, Pllanë etj. Nga kërkim-vlerësimi i bërë nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, janë evidentuar dy vendburime dhe objekte të shkëmbinjeve karbonate në afërsi të Shënkollit (në komunën Zejmen - Tab 19).

Vendburimet dhe objektet e shkëmbinjeve karbonate në basenin e Matit

Tab. 14

Nr.	Vendi, objekti	Rajoni	Lloji i gurit dekorativ	Përberja kimike në %				Vetite fiziko-mekanike		Rezervat Resurset në m ³
				CaO	MgO	SiO ₂	Fe ₂ O ₃	Rez.sht	P.vol	
								g/cm ²	gr/cm ³	
1.	Manati	Lezhë	Gëlqëror	50.00	0.75		0.60	1 000	2.62	1 722 647
2.	Spiten	Lezhë	Gëlqëror	52.16	0.62		0.40	1 350	2.70	4 053 709

